(h) ndryshimet në të drejtat dhe privilegjet e bashkangjitura një kategorie të caktuar aksionesh;

(i) miratimi i çdo financimi që do t'i ofrohet çdo Aksionari nga Shoqwrisw; dhe

(j) përcaktimi i numrit të anëtarëve dhe emërimi i anëtarëve të Kwshillit.

(k) emetimi i obligacioneve, opsioneve ose interesave të tjera (duke përfshirë në formën e letrave me vlerë të konvertueshme ose çdo forme tjetër), mbi ose në kapitalin Aksionar të Shoqwrisw;

(l) miratimi i çdo transferimi material të aseteve të Shoqwrisw;

(m) miratimi i të gjitha propozimeve që vijnë nga Kwshilli që kërkojnë miratim nga Asambleja e Përgjithshme sipas dispozitave të këtij Statuti ose Marrëveshjes së Aksionarëve; dhe

(n) çdo çështje tjetër e parashikuar nga ky Statut ose ligji në fuqi, ose që Asambleja e Përgjithshme e konsideron të rëndësishme për t'u zgjidhur dhe për të cilën është kompetente.

4. Shoqëria nuk do të ndërmarrë, dhe Aksionarët do të sigurojnë që Shoqëria të mos ndërmarrë, asnjë veprim, ose asgje tjetër që është analoge me ose ka efekt në thelb të ngjashëm me një veprim të tillë, qoftë i ndërmarrë si një transaksion i vetëm ose si një seri transaksionesh të lidhura ose të ndërlidhura (duke përfshirë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të marra në një mbledhje të rithirrur për shkak të mungesës së kuorumit), përveçse me votën unanime

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS SAIMIR SHEFA CERTIFIKATË NR.346 ANGLEZE

pro në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme ose ndryshe me shkrim të të dy Aksionarëve, në lidhje me çështjet që kërkojnë Shumicën e Kualifikuar të Aksionarëve.

Neni 14 – Asambleja e Përgjithshme: Mbledhjet, Kuorumi dhe Vendimmarrja

14.1. Frekuenca e Mbledhjeve

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të mbahen çdo vit, brenda 4 (katër) muajve pas përfundimit të çdo Viti Financiar ose në çdo kohë tjetër të kërkuar nga ligji në fuqi, ose me kërkesë me shkrim të 3 (tre) anëtarëve të Kwshillit, Auditorit të Jashtëm, Drejtorit Ekzekutiv ose një Aksionari. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të kryesohen nga Kryetari i Kwshillit.

14.2. Vendndodhja e Mbledhjes

Të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të mbahen në Shqipëri, ose në një vend tjetër për të cilin do të bien dakord Aksionarët.

14.3. Njoftimi dhe Rendi i Ditës

1. Njoftimi për thirrjen e një mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme duhet të dorëzohet të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë një rend dite të detajuar nw mwnyrw tw arsyeshme (duke përfshirë çdo material të kërkuar) që përcakton, ndër të tjera, ato tema që ndonjë nga Aksionarët ose Kwshilli mund të ketë propozuar të diskutohet ose të votohet në mbledhje.
2. Një heqje dorë me shkrim nga njoftimi, e nënshkruar nga një nënshkrues i autorizuar i një Aksionari, do të konsiderohet ekuivalente me një njoftim drejtuar atij Aksionari. Pjesëmarrja e një Aksionari në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme do të përbëjë një heqje dorë nga njoftimi drejtuar atij Aksionari për atë mbledhje, përveç nëse një pjesëmarrje e tillë është bërë vetëm për të kundërshtuar njoftimin e papërshtatshëm.

14.4. Kuorumi dhe Mbledhja e Shtyrë

1. Kuorumi për çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme duhet të arrihet me pjesëmarrjen e të dy Aksionerëve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme (AP) personalisht ose me përfaqësues.
2. Nëse nuk ka kuorum për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme brenda 1 (një) orë nga koha e caktuar për fillimin e mbledhjes, ose nëse gjatë mbledhjes nuk ka më kuorum, mbledhja duhet të shtyhet në një kohë dhe vend të përcaktuar nga Kryetari (një "Mbledhje e Shtyrë e Asamblesë së Përgjithshme"), dhe Aksionarëve duhet t'u jepet njoftim të paktën 5 (pesë) ditë përpara për Mbledhjen e Shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme. Rendi i ditës për Mbledhjen e Shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme do të jenë ato çështje në rendin e ditës të mbledhjes fillestare të cilat nuk u trajtuan në mbledhjen fillestare (përveç nëse të gjithë Aksionarët bien dakord ndryshe). Nëse nuk ka kuorum në Mbledhjen e Shtyrë të AP-së brenda 1 (një) ore nga

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS ANGLEZE
SAIMIR SHEFA
CERTIFIKATË NR.34

ora e specifikuar për Mbledhjen e Shtyrë të AP-së, një mbledhje e tillë do të shtyhet për jo më shumë se 2 (dy) ditë pune në të njëjtin vend dhe orë të ditës.

14.5. Prokurë

Një Aksionar mund të emërojë çdo Person për të përfaqësuar një Aksionar të tillë në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, me kusht që ky Person të mos jetë Drejtor dhe të jetë emëruar siç duhet si përfaqësues me shkrim, dhe që njoftimi për një emërim të tillë t'i jetë dorëzuar Kwshillit para mbledhjes.

14.6. Mënyra e Pjesëmarrjes

Kushtet dhe procedurat për prokurën, mbledhjet telefonike, video ose elektronike të Kwshillit do të zbatohen, mutatis mutandis, për Asamblenë e Përgjithshme. Një përfaqësues i një Aksionari nuk mund të jetë Drejtor.

14.7. Pëlqimet me Shkrim

Çdo veprim që duhet të ndërmerret nga Asambleja e Përgjithshme mund të ndërmerret pa zhvillimin e një mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme, nëse Aksionarët miratojnë unanimisht me shkrim ndërmarrjen e një veprimi të tillë. Pëlqimet me shkrim mund të nënshkruhen në çdo numër kopjesh të njëjta, secila e nënshkruar nga një Aksionar, dhe të gjitha kopjet e marra së bashku do të përbëjnë provë të vendimit. Një veprim i tillë do t'i paraqitet mbledhjes së parë të disponueshme të Asamblesë së Përgjithshme, e cila do ta ratifikojë atë; pas këtij ratifikimi, nëpërmjet një vendimi përkatës, ai do të hyjë në fuqi.

14.8. Procesverbali

Procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme do të mbahen nga Sekretari, do të regjistrohen në gjuhën angleze, do t'u shpërndahen Aksionarëve gjatë ose pas mbledhjes dhe, nëse bihet dakord, do të nënshkruhen nga Kryetari në mbyllje të mbledhjes. Dokumentet që vërtetojnë miratimin e vendimeve do të arkivohen nga Sekretari në librin e procesverbaleve, i cili do të mbahet në Zyrën Qendrore.

Neni 15 – Kwshilli drejtues: Përbërja dhe Emërimi

1. Kwshilli do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë (secili "Drejtor"), duke përfshirë Kryetarin dhe Drejtorin Ekzekutiv.

2. Që nga Data e themelimit:

(a) Fincantieri S.p.A. do të ketë të drejtën të emërojë 4 (katër) Drejtorë (secili, një "Drejtor i emëruar nga Fincantieri"); dhe

(b) KAYO sh.a. do të ketë të drejtën të emërojë 3 (tre) Drejtorë (secili, një "Drejtor i emëruar nga KAYO").

3. Aksionerët do të sigurojnë, qoftë nëpërmjet votimit në një Asamble të Përgjithshme ose nëpërmjet ekzekutimit të një vendimi me shkrim, që të emëruarit përkatës të Aksionarëve në

PËRKTHYES I GJUHËS ANGLEZE SAIMIR SHEFA CERTIFIKATË NR.346

përputhje me Nenin 15.2 të emërohen ose të shkarkohen nga detyra në Këshill, sipas rastit, menjëherë pasi të informohen për identitetin e të emëruarit/ëve të propozuar.

4. Çdo Drejtor do të shërbejë për një mandat prej 3 (tre) vitesh pas emërimit të tij ose të saj, ose një mandat më të shkurtër që mund të vendosë Aksionari emërues, i zgjatshëm për mandate të njëpasnjëshme sipas gjykimit të Aksionarit emërues, në çdo rast me kusht që të ndodhë më i hershmi nga: (i) një pasardhës i emëruar nga Aksionari emërues për këtë Drejtor; (ii) data në të cilën Aksionari që e ka emëruar pushon së qeni Aksioner; ose (iii) dorëheqja, qoftë me veprim apo mosveprim, vdekje apo paaftësi ose shkarkim të këtij Drejtori.

5. Një Drejtor mund të shkarkohet dhe zëvendësohet sipas gjykimit të Aksionarit që e ka emëruar atë në çdo kohë me njoftim me shkrim drejtuar Aksionarit tjetër dhe Sekretarit të Këshillit, dhe Aksionarët duhet (i) të ndërmarrin menjëherë të gjitha veprimet e nevojshme për ta bërë të zbatueshme shkarkimin ose zëvendësimin dhe (ii) të kenë të drejtën të emërojnë një Drejtor tjetër në vendin e tij ose të saj. Secili prej Aksionarëve mund të emërojë një zëvendësues për një Drejtor të emëruar prej tij nëse vendi i atij Drejtori në Këshill lirohet. Përveç kësaj, çdo Drejtor mund të japë dorëheqjen në çdo kohë me njoftim me shkrim drejtuar Aksionerëve, Këshillit dhe Sekretarit.

6. Çdo Aksionar që shkarkon një Drejtor do të jetë përgjegjës dhe do të dëmshpërblejë Aksionarin tjetër dhe Shoqerinë kundër çdo pretendimi, të çfarëdo natyre, të këtij Drejtori, që rrjedh nga shkarkimi.

Neni 16 – Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv

1. Kryetari emërohet nga radhët e Drejtorëve të emëruar nga KAYO,
2. Drejtori Ekzekutiv/Administratori emërohet nga Fincantieri.
3. Kryetari kryeson mbledhjet e Këshillit.
4. Drejtori Ekzekutiv/Administratori ka kompetenca të përgjithshme menaxhimi dhe përfaqësimi të Shoqërisë, duke përfshirë edhe zbatimin e çdo vendimi, strategjie dhe direktive të Këshillit, si dhe përfaqësimin ligjor dhe gjyqësor të tyre. Në këtë drejtim, Drejtori Ekzekutiv kryen të gjitha veprimet dhe transaksionet në rrjedhën e zakonshme dhe jashtë rrjedhës së zakonshme të biznesit, përveç në lidhje me çështjet që sipas këtij Statuti ose Marrëveshjes së Aksionarëve i rezervohen Këshillit ose Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 17 – Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv/Administratorit

Drejtori Ekzekutiv/Administratori do të ketë, ndër të tjera, kompetencat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

(a) të ndërmarrë të gjitha veprimet që lidhen me administrimin e përditshëm të aktivitetit administrativ, financiar dhe tregtar të Shoqërisë;

(b) të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta dhe të miratojë, ndërmarrë ose nxjerrë çdo akt, veprim ose dokument që lidhet dhe synon ruajtjen e përfaqësimit ligjor dhe marrëdhënieve të Shoqërisë me institucione të tjera, media, ngjarje publike dhe të ngjashme;

(c) të fillojë, negociojë dhe ekzekutojë kontrata tregtare dhe të tjera që lidhen me biznesin e Shoqërisë, sipas pragjeve të përcaktuara në këtë Statut dhe dokumente të tjera të Shoqërisë;

(d) së bashku me Drejtorin Financiar, të sigurojë mbajtjen e duhur të librave dhe regjistrave kontabël të Shoqërisë;

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS
SAIMIR SHEFA
CERTIFIKATË NR.346
ANGLEZE

(e) së bashku me Drejtorin Financiar, të përgatisë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin mbi aktivitetin e Shoqërisë, të gjitha për t'i paraqitur për miratim Këshillit së bashku me propozimin për shpërndarjen e fitimit, para miratimit përfundimtar nga Asambleja e Përgjithshme;

(f) të përgatisë dhe nënshkruajë Buxhetin Vjetor të Shoqërisë që do t'i paraqitet për miratim Këshillit, duke marrë parasysh rekomandimet e të gjitha departamenteve;

(g) të raportojë në Këshill mbi zbatimin e politikave financiare dhe tregtare dhe mbi zbatimin e projekteve me rëndësi të veçantë për Shoqërinë;

(h) të përgatisë dhe hartojë dokumente që lidhen me programet, strategjitë, objektivat, buxhetet dhe planet e investimeve që bien brenda kompetencës së miratimit të Këshillit dhe Asamblesë së Përgjithshme ose që caktohen rast pas rasti më pas;

(i) të miratojë, ndërmarrë ose nxjerrë çdo akt, veprim ose dokument që lidhet me shpenzimet, aspektet kontabël dhe financiare të aktiviteteve të Shoqërisë, për një shumë deri në 500,000 euro (pesëqind mijë euro) për transaksion të vetëm, i cili nuk është buxhetuar dhe miratuar nga Këshilli Drejtues.

(j) të miratojë, ndërmarrë ose nxjerrë çdo akt, veprim ose dokument që lidhet me miratimin dhe zbatimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit;

(k) të miratojë, ndërmarrë ose nxjerrë çdo akt, veprim ose dokument për mirëmbajtjen dhe monitorimin e stafit, niveleve dhe atributeve të njohurive-aftësive, pritjeve dhe motivimit për të përmbushur kërkesat organizative;

(l) të miratojë, ndërmarrë ose nxjerrë çdo akt, veprim ose dokument që lidhet me fillimin, vazhdimin dhe finalizimin e procedurave të prokurimit bazuar në nevojat e Kompanisë;

(m) të miratojë, ndërmarrë ose nxjerrë çdo akt, veprim ose dokument që lidhet me fillimin e veprimeve dhe procedurave ligjore, si dhe përfaqësimin e Kompanisë në veprime dhe procedura të tilla ligjore;

(n) të miratojë, ndërmarrë ose nxjerrë çdo akt, veprim ose dokument që lidhet me aspektet tregtare, të shpenzimeve, të kontabilitetit dhe financiare të aktivitetit të Shoqërisë në përputhje me pragjet e vlerës që mund të përcaktohen herë pas here nga Këshilli;

(o) të depozitojë, transferojë dhe tërheqë në ose nga llogaritë bankare të Shoqërisë, duke përfshirë plotësimin, lëshimin dhe miratimin e çeqeve, drafteve dhe instrumenteve të tjera që lidhen me llogari të tilla bankare, dhe të kryejë çdo çështje tjetër të lidhur në përputhje me kompetencat e dhëna Drejtorit Ekzekutiv ose me vendimet ose miratimet e Këshillit ose të Asamblesë së Përgjithshme, sipas rastit;

(p) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe nga ky Statut ose me vendim të Këshillit;

(q) të krijojë një strukturë të përshtatshme organizative, sisteme të menaxhimit të informacionit dhe linja raportimi për të mundësuar arritjen efektive të objektivave të Shoqërisë;

(r) çdo kompetencë ose përgjegjësi tjetër që i është dhënë Drejtorit Ekzekutiv me ligj, këtë Statut, ose konkretisht me vendim të Këshillit ose të Asamblesë së Përgjithshme, si dhe çdo kompetencë ose përgjegjësi të mbetur që nuk i rezervohet shprehimisht Këshillit ose Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 18 – Drejtori Kryesor i Operacioneve dhe Drejtori Kryesor Financiar

1. Drejtori Kryesor i Operacioneve ("COO"), me detyrën e mbikëqyrjes së operacioneve të përditshme të biznesit dhe raportimit te Drejtori Ekzekutiv, do të emërohet nga KAYO.

2. Drejtori Financiar ("Drejtori Financiar") emërohet nga Këshilli dhe i delegohen kompetenca nga ai.

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS
SAIMIR SHEFA
CERTIFIKATË
NR. 346
ANGLEZE

3. Drejtuesit e njësive funksionale të Shoqërisë emërohen nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 19 – Sekretari i Këshillit

Çështjet administrative të Këshillit menaxhohen nga një sekretar ("Sekretari"), i cili emërohet me një vendim të Këshillit dhe shërben për një periudhë që përcakton Këshilli.

Neni 20 – Mbledhjet e Këshillit

20.1. Frekuenca dhe Vendi

Këshilli do të mblidhet të paktën 4 (katër) herë në vit. Mbledhjet, në varësi të dispozitave të tjera të këtij Statuti, do të mbahen në Shqipëri në Selinë Qendrore, përveç nëse është rënë dakord ndryshe me një vendim të Këshillit, me kusht që mbledhja e parë të mbahet sa më shpejt të jetë e mundur praktikisht pas Përfundimit (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Aksionarëve), por në çdo rast jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas kësaj, dhe që të paktën 1 (një) mbledhje e Këshillit të mbahet brenda 3 (tre) muajve nga fundi i çdo Viti Financiar (ose një periudhe më të shkurtër që mund të kërkohet nga ligji në fuqi ose për të përmbushur kërkesat e llogarive të konsoliduara të Aksionarëve) në mënyrë që Këshilli të miratojë pasqyrat financiare të Shoqërisë, të përgatisë raportin e Këshillit dhe të përgatisë rekomandimet e Këshillit në lidhje me shpërndarjen e dividentëve.

20.2. Mbledhje të Jashtëzakonshme

Një mbledhje e jashtëzakonshme e Këshillit mund të thirret me njoftim të dhënë nga të paktën 1 (një) Drejtor me shkrim te Kryetari dhe Sekretari, për shkak të mirë ose arsye thelbësore që lidhet me Biznesin ose Shoqërinë, shqyrtimi i të cilit nuk mund të shtyhet në mënyrë të arsyeshme për një mbledhje të planifikuar të Këshillit.

20.3. Njoftimi

Njoftimi për çdo mbledhje të Këshillit Drejtues (të planifikuar ose të posaçme, por duke përjashtuar një Mbledhje të Shtyrë) duhet të jepet të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara, dhe ky njoftim duhet të përfshijë rendin e ditës, përveç rastit të urgjencës, kur një mbledhje e Këshillit Drejtues mund të thirret me një afat njoftimi më të shkurtër, me kusht që në këtë rast njoftimi të përcaktojë natyrën dhe arsyet e urgjencës. Një Drejtor mund të heqë dorë, me shkrim (për sa i përket atij Drejtori), nga çdo kërkesë për njoftim paraprak për çdo mbledhje. Heqja dorë me shkrim dhe në mënyrë retrospektive nga njoftimi, e nënshkruar nga një Drejtor, do të konsiderohet e barasvlershme me një njoftim drejtuar atij Drejtori. Pjesëmarrja e një Drejtori në një mbledhje të Këshillit Drejtues do të përbëjë heqje dorë nga njoftimi (për sa i përket atij Drejtori) për atë mbledhje, përveç rastit kur kjo pjesëmarrje është bërë vetëm me qëllim kundërshtimin e parregullsisë së njoftimit.

20.4. Me Prokurë

Një Drejtor mund të përfaqësohet në çdo mbledhje të Këshillit nga një Drejtor tjetër, me kusht që ky Drejtor të jetë emëruar siç duhet si me prokurë nga i pari me shkrim dhe njoftimi për një emërim të tillë t'i dërgohet Sekretarit para mbledhjes.

20.5. Mënyra e Pjesëmarrjes

Një Drejtor (ose me prokurë e tij ose e saj) mund të marrë pjesë në çdo mbledhje të Këshillit personalisht, me telefon, me video-konferencë ose me çdo mjet tjetër të ngjashëm elektronik përmes të cilit të gjithë Drejtorët mund të komunikojnë njëkohësisht. Kjo pjesëmarrje do të përbëjë prani në një mbledhje të tillë në masën që çdo Drejtor të ketë një mundësi të plotë për të diskutuar, për të bërë dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të dëgjuar, dhe për t'u dëgjuar nga të gjithë pjesëmarrësit e tjerë qartë dhe në kohë reale, dhe është në gjendje të identifikojë se cili Drejtor po flet.

20.6. Procesverbali

Procesverbali i mbledhjes së Këshillit do të mbahet nga Sekretari, do të regjistrohet në gjuhën angleze, do t'i shpërndahet Këshillit pas mbledhjes dhe do të nënshkruhet nga secili prej Drejtorëve që ishin të pranishëm (personalisht ose me prokurë) në mbledhjen përkatëse të Këshillit. Dokumentet që dëshmojnë miratimin e vendimeve do të arkivohen nga Sekretari në librin e procesverbaleve, i cili do të mbahet në Zyrën Qendrore.

Neni 21 – Këshilli Drejtues: Kuorumi dhe Vendimet

21.1. Kuorumi

1. Kuorumi për çdo mbledhje të thirrur rregullisht të Këshillit do të jetë të paktën 4 (katër) Drejtorë të pranishëm personalisht ose me prokurë, me kusht që të jenë të pranishëm të paktën 2 (dy) Drejtorë të emëruar nga Fincantieri dhe 2 (dy) Drejtorë të emëruar nga KAYO.

21.2. Mbledhja e Shtyrë

Nëse kuorumi nuk është i pranishëm për një mbledhje të Këshillit Drejtues brenda 1 (një) ore nga koha e caktuar për fillimin e mbledhjes, ose nëse gjatë mbledhjes kuorumi pushon së qeni i pranishëm, mbledhja do të shtyhet për një kohë dhe në një vend të përcaktuar nga Kryetari i Mbledhjes (një "Mbledhje e Shtyrë"), dhe Drejtorëve do t'u jepet të paktën 5 (pesë) ditë njoftim për këtë Mbledhje të Shtyrë, ndërsa rendi i ditës për Mbledhjen e Shtyrë do të përfshijë ato çështje që ishin në rendin e ditës së mbledhjes fillestare dhe që nuk u trajtuan në mbledhjen fillestare (përveç nëse të gjithë Drejtorët bien dakord ndryshe).

21.3. Votimi

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe shprehimisht në këtë Statut ose në Marrëveshjen e Aksionerëve, vendimet e Këshillit që kanë të bëjnë me çështje të tjera përveç Çështjeve të Rezervuara të Këshillit do të miratohen nga shumica e Drejtorëve të pranishëm në mbledhje.

PËRKTHYES ZYRTAR GJUHËS SAIMIR SHEFA CERTIFIKATË NR 46 ANGLEZE

2. Vendimet që kanë të bëjnë me Çështjet e Rezervuara të Këshillit të përcaktuara në Nenin 22.3 do të miratohen me votën pro të të paktën 2 (dy) Drejtorëve të emëruar nga Fincantieri dhe 2 (dy) Drejtorëve të emëruar nga KAYO.

3. Kryetari do të ketë votën vendimtare në rast barazimi në një mbledhje të Këshillit.

21.4. Pëlqimi me Shkrim

Çdo veprim që do të ndërmerret nga Këshilli Drejtues mund të ndërmerret pa një mbledhje të Këshillit me miratimin paraprak unanim me shkrim të të gjithë Drejtorëve që kanë të drejtë të votojnë për një veprim të tillë. Pëlqimet me shkrim mund të nënshkruhen në çdo numër kopjesh, secila e nënshkruar nga një ose më shumë Drejtorë, dhe të gjithë kopjet mbahen si evidence e vendimit. Ky veprim do të paraqitet më pas në mbledhjen e parë të disponueshme të Këshillit drejtues, e cila do ta ratifikojë atë, pas të cilit ratifikim, në bazë të një vendimi të përshtatshëm, ai do të hyjë në fuqi.

Neni 22 – Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Shoqëria dhe Biznesi i saj do të menaxhohen nga Këshillit Drejtues. Në varësi të Nenit 15 (Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Drejtues) dhe sipas strukturës organizative të rënë dakord nga Aksionarët, Këshilli, herë pas here, do të emërojë ato pozicione brenda Shoqërisë që do të jenë ekipi ekzekutiv i menaxhimit të përditshëm të Shoqërisë ("Ekipi i Menaxhimit").

2. Këshilli do të vendosë për çështjet e mëposhtme në përputhje me kërkesat e votimit të përcaktuara në Nenin 21.3.1:

(a) mbikëqyrja e performancës së Drejtorit Ekzekutiv dhe Drejtuesit të Operacioneve dhe vlerësimi i aktivitetit të tyre, duke përfshirë miratimin e politikave për mbikëqyrjen e performancës së ekipit të menaxhimit ekzekutiv të lartë të Shoqërisë;

(b) dhënia Asamblesë së Përgjithshme një përshkrim të aktivitetit të Auditorit të Jashtëm të Shoqërisë;

(c) paraqitja në Asamblenë e Përgjithshme propozimeve dhe rekomandimeve, nëse kërkohet, për çështje që bien nën kompetencën e Asamblesë së Përgjithshme;

(d) mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit dhe politikave për menaxhimin e riskut dhe kontrollin e brendshëm dhe marrja e raporteve për të monitoruar profilin e riskut të Shoqërisë. Politikat kryesore të kontrollit të brendshëm do të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, politikën e sinjalizimit, politikën e konfliktit të interesit dhe politikën e transaksioneve me palët e lidhura;

(e) vlerësimin e aktivitetit të njësisë së auditimit të brendshëm dhe dërgimin e rekomandimeve te Drejtori Ekzekutiv në lidhje me kryerjen e aktiviteteve të saj;

(f) marrjen e raporteve periodike nga njësia e auditimit të brendshëm nëse kërkohet nga të paktën 1 (një) anëtar i Këshillit, dhe vlerësimin e këtyre raporteve dhe/ose dhënien e rekomandimeve te drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm për çështje specifike;

(g) miratimin dhe miratimin e Planit të Biznesit dhe Buxhetit Vjetor të Shoqërisë;

(h) miratimin e pasqyrave financiare, raporteve vjetore të aktiviteteve dhe raporteve të tjera, për t'i paraqitur Asamblesë së Përgjithshme ose siç kërkohet me ligj ose nga ky Statut;

(i) miratimin e krijimit të komiteteve brenda Keshillit dhe miratimin e përbërjes dhe rregulloreve të tyre;

3. Çështjet e mëposhtme përbëjnë Çështje të Rezervuara të Këshillit dhe kërkojnë miratim në përputhje me Nenin 21.3.2:

(a) shqyrtimi dhe miratimi i të gjitha ofertave tregtare dhe kontratave përkatëse mbi pragjet e përcaktuara në këtë Statut ose në dokumentacionin tjetër të Shoqërisë, duke u kuptuar që çdo kontratë që sjell humbje do të kërkojë miratimin e Drejtorit Ekzekutiv;

(b) emërimi i Sekretarit të Kshillit dhe menaxherëve të tjerë të lartë (domethënë, përveç drejtuesve të njësive funksionale dhe menaxherëve të nivelit më të ulët) dhe miratimi i përshkrimit të detyrave, detyrimeve dhe shpërblimeve të tyre;

(c) miratimi i organizimit të strukturës së brendshme të Shoqërisë, si dhe i rregulloreve të brendshme të Shoqërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës;

(d) përcaktimi dhe ndryshimi i nënshkruesve të autorizuar të Shoqërisë;

(e) propozimi i çdo financimi që do të merret nga Shoqëria para miratimit përfundimtar nga Asambleja e Përgjithshme;

(f) propozimi i të gjitha financimeve që do t'i ofrohen çdo pale nga Shoqëria para miratimit përfundimtar nga Asambleja e Përgjithshme;

(g) propozimi i rregulloreve të brendshme të Këshillit;

(h) dhënien e rekomandimeve të saj Asamblesë së Përgjithshme mbi planin e zhvillimit dhe zgjerimit të produkteve të Shoqërisë, politikat e përgjithshme të investimeve, objektivat strategjike, planet operative, para se t'i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme për miratim përfundimtar;

(i) zgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për miratim dhe emërim nga Asambleja e Përgjithshme, në bazë të konsideratave konkurruese dhe tregtare të palëve të treta dhe me propozim nga KAYO;

(j) çdo çështje tjetër e përcaktuar shprehimisht si Çështje e Rezervuar e Këshillit sipas këtij Statuti ose Marrëveshjes së Aksionarëve.

4. Nëse një Çështje e Rezervuar e Këshillit nuk miratohet në 2 (dy) mbledhje të Këshillit të thirrura rregullisht, të mbajtura të paktën 10 (dhjetë) Ditë Pune larg njëra-tjetrës, çështja do t'u referohet Aksionarëve për zgjidhje në përputhje me procedurën e përshkallëzimit të përcaktuar në Marrëveshjen e Aksionarëve.

5. Kur një çështje është përfshirë shprehimisht në një Plan Biznesi i cili është miratuar tashmë nga Këshilli, ose është miratuar ndryshe unanimisht nga Aksionarët në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme sipas çështjeve që kërkojnë Shumicë të Kualifikuar të Aksionarëve, nuk do të kërkohet miratim i mëtejshëm i Këshillit.

Neni 23 – Shpërblimet dhe Shpenzimet e Drejtorëve

Shoqëria do të jetë përgjegjëse për rimbursimin e Drejtorëve për shpenzimet dhe shpërblimet në lidhje me detyrat e kryera nga Drejtorë të tillë si anëtarë të Këshillit.

Neni 24 – Zbulimi i Informacionit nga Drejtorët

Pavarësisht çdo dispozite tjetër të këtij Statuti, çdo Drejtor i emëruar nga një Aksionar mund të zbulojë të gjithë informacionin e fituar në cilësinë e tij ose të saj si Drejtor tek Aksionari që e ka emëruar atë ose atë, mbi bazën e nevojës për të ditur, duke garantuar

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS SAIMIR SHEHU CERTIFIKATË NR. 46 ANGLEZE

transparencë të plotë në lidhje me personat të cilëve u zbulohet informacioni dhe duke mbajtur prova me shkrim të zbulimeve të tilla, përveç se asnjë Drejtor nuk do të lejohet të zbulojë.

Neni 25 – Transaksionet e Palëve të Lidhura dhe Konfliktet e Interesit

1. Të gjitha Transaksionet e Palëve të Lidhura, duke përfshirë shërbimet brenda grupit dhe nënkontratat, duhet të negociohen me mirëbesim dhe në përputhje me parimin e gjatësisë së krahut siç përcaktohet në Udhëzimet e OECD-së për Çmimin e Transferimit për Ndërmarrjet Shumëkombëshe dhe Administratat Tatimore, dhe duhet të dokumentohen në një studim të çmimit të transferimit të kryer nga një këshilltar i emëruar bashkërisht nga të dy Aksionarët.

2. Këshilli duhet të shqyrtojë dhe miratojë një politikë të konfliktit të interesit e cila, të paktën, duhet të jetë në përputhje me politikat e konfliktit të interesit të vetë Aksionarëve.

3. Nëse në çdo kohë: (i) Shoqëria dëshiron të zbatojë ose ushtrojë ndonjë të drejtë sipas një Transaksioni të Palëve të Lidhura ose ndonjë të drejtë ose mjet juridik tjetër që mund të ketë në lidhje me një Palë të Lidhur (duke përfshirë çdo të drejtë për të ndërprerë një marrëveshje ose rregullim); (ii) Shoqëria ka ndonjë pretendim kundër një Pale të Lidhur ose është subjekt i një pretendimi nga një Palë e Lidhur, në secilin rast sipas ose në lidhje me këtë Statut, Marrëveshjen e Aksionarëve ose çdo Transaksion të Palëve të Lidhura; (iii) në lidhje me ndonjë Drejtor, çdo interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë financiar ose tregtar i atij Drejtori lind nga çdo marrëveshje, kontratë, proces gjyqësor ose procedurë tjetër ekzistuese ose e propozuar midis Shoqërisë ose ndonjë prej Filialeve të saj, nga njëra anë, dhe atij Drejtori ose çdo subjekti të Kontrolluar nga ai Drejtor, nga ana tjetër; ose (iv) Shoqëria dëshiron të hyjë në një Transaksion me Palët e Lidhura (ose dëshiron të modifikojë, ndryshojë ose përfundojë një Transaksion ekzistues me Palët e Lidhura), (secila, një "Çështje Konflikti"), atëherë: (a) në varësi të paragrafit (b) më poshtë, Këshilli do të mblidhet menjëherë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga ndodhja e Çështjes së Konfliktit për të miratuar një vendim të përshtatshëm; dhe (b) nëse Çështja e Konfliktit mbetet e pazgjidhur, ajo do të zgjidhet sipas mekanizmit të zgjidhjes së bllokimit të përcaktuar në Marrëveshjen e Aksionarëve.

4. Asnjë Drejtor që është subjekt i një Çështjeje Konflikti nuk do të: (a) të ketë të drejtë të marrë ndonjë material të qarkulluar nga Shoqëria në masën që lidhet me një Çështje të tillë Konflikti; (b) të ketë të drejtë të marrë pjesë në çdo pjesë të një mbledhjeje të Këshillit ku diskutohet kjo Çështje e Konfliktir; (c) të ketë të drejtë të votojë për Çështjen e Konfliktit në çdo mbledhje të Këshillit (ose me anë të një vendimi me shkrim); dhe (d) për qëllimet e çdo mbledhjeje të Këshillit për të shqyrtuar çdo çështje që lidhet me Çështjen e Konfliktit, të llogaritet në kuorum, dhe kërkesat e kuorumit sipas kësaj do të përshtaten sipas nevojës në mënyrë që të mos kërkohet prania e Drejtorit që i nënshtrohet Çështjes së Konfliktit, në secilin rast, pa miratimin paraprak me shkrim (në masën që një miratim i tillë lejohet nga ligji në fuqi) të Aksionarit tjetër.

Neni 26 – Pronësia Intelektuale

1. Të gjitha Pronat Intelektuale të licencuara nga një Aksionar (një "Licensdhënës") për Shoqërinë do të mbeten në çdo kohë pronë e Licensuesit dhe do të mbeten pronë e tij.

2. Shoqëria nuk do të lejojë dhe nuk do të lejojë asnjë palë të tretë që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të: (i) çmontojë, dekompilojë, dekriptojë ose të bëjë inxhinieri të kundërt ndonjë

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS ANGLEZE SAIMIR SHEHA CERTIFIKATË NR.346

softuer, firmuere, harduer ose produkte ose materiale të tjera që përmbajnë Pronat Intelektuale të licencuesit; (ii) të përdorë ndonjë teknikë, proces ose metodë për të përcaktuar dizajnin, strukturën, përbërjen ose ndonjë element themelor të Pronave Intelektuale të licencuesit; ose (iii) të përdorë Pronën Intelektuale Intelektuale të Licencuesit për të krijuar vepra ose produkte derivative konkurruese për Biznesin.

3. Shoqëria nuk do të zbulojë, shpërndajë ose vërë në dispozicion Pronën Intelektuale Intelektuale të Licencuesit për asnjë palë të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Licencuesit, përveç rasteve të lejuara shprehimisht sipas Marrëveshjes së Aksionarëve ose licencës përkatëse.

4. Shoqëria do të zbatojë dhe mirëmbajë masat e duhura për të siguruar pajtueshmërinë me kushtet e këtij Neni 26, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, trajnimin e punonjësve dhe masat e duhura të mbrojtjes dhe konfidencialitetit.

5. Të gjitha të Drejtat e Pronësisë Intelektuale të gjeneruara si rezultat i aktiviteteve dhe operacioneve të Biznesit ("Pronësia Intelektuale e Parë") do të jenë pronë e vetme dhe ekskluzive e Shoqërisë. Aksionarët nuk do të kenë të drejta individuale pronësie mbi Pronën Intelektuale Intelektuale, e cila do të licencohet pa pagesë për Aksionarët. Aksionarët do të negociojnë me mirëbesim të drejtat dhe përdorimin e Pronës Intelektuale Intelektuale pas përfundimit ose skadimit të Marrëveshjes së Aksionerëve.

6. Çdo transferim, licencim ose përpunim tjetër i të Drejtave të Pronësisë Intelektuale në çdo rast i nënshtrohet ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve në fuqi të autoriteteve kompetente, duke përfshirë edhe në lidhje me rregullat e investimeve të huaja dhe çdo regjim të zbatueshëm të kontrollit të eksporteve.

TITULLI IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITË, AUDITI DHE DIVIDENDET

Neni 27 – Viti Financiar

Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Viti i parë Financiar i Shoqërisë do të bihet dakord nga Aksionerët në mënyrë që të përfundojë më 31 Dhjetor të vitit në të cilin ndodh Data e themelimit, në përputhje me ligjin përkatës shqiptar.

Neni 28 – Librat dhe Regjistrat

1. Shoqëria do të mbajë libra dhe regjistra në përputhje me ligjin përkatës shqiptar në Selinë e saj Qendrore, duke përfshirë:
(a) librat e llogarive të Shoqërisë, të përgatitur dhe të mirëmbajtur në përputhje me SNRF-të dhe ligjin përkatës shqiptar dhe politikën kontabël të miratuar nga Shoqëria;
(b) pasqyrat financiare të paauditurara, të përgatitura në anglisht, me shifra të shprehura në Euro dhe Lek në bazë tremujore;
(c) pasqyrat financiare vjetore të audituara, të përgatitura në anglisht, me shifra të shprehura në Euro dhe Lek në përputhje me SNRF-të, ligjin përkatës shqiptar dhe politikën kontabël të Shoqërisë, dhe të certifikuara nga Auditori i Jashtëm; dhe

PËRKTHYES ZYRTAR GJUHËS SAIMIR SHIMA CERTIFIKATË N 346 ANGLEZE

(d) një kopje të Marrëveshjes së Aksionarëve dhe të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara për respektimin e saj, së bashku me të gjitha të dhënat e tjera të nevojshme, të përshtatshme ose të rastësishme për Biznesin.
2. Shoqëria do të kryejë një shqyrtim të librave dhe llogarive në baza mujore, përveç nëse specifikohet ndryshe në politikën kontabël.

Neni 29 – Raportet Financiare

Shoqëria do të përgatisë dhe shpërndajë për secilin Aksionar: (i) raporte tremujore në lidhje me Biznesin dhe aktivitetet e Shoqërisë për të këshilluar Aksionerët mbi performancën operative dhe financiare të Shoqërisë; dhe (ii) nga Data e themelimit, jo më vonë se 1 Prilli i çdo viti (ose një datë tjetër e rënë dakord nga Aksionarët), një pasqyrë të audituar të pozicionit financiar (bilanci), një pasqyrë të audituar të të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe një pasqyrë të audituar të ndryshimeve në kapital që tregon rezultatet e operacioneve për Vitin Financiar paraprak, për miratim nga Aksionarët.

Neni 30 – Auditori i Jashtëm

1. Me propozim të KAYO-s, Këshilli do të zgjedhë, dhe Aksionarët do të miratojnë dhe emërojnë me shumicë të kualifikuar të Aksionarëve në Asamblenë e Përgjithshme, një firmë kontabiliteti të njohur ndërkombëtarisht si Auditor të Jashtëm të pavarur të Shoqërisë në përputhje me këtë Statut dhe bazuar në konsiderata konkurruese dhe tregtare të barabarta.
2. Auditori i Jashtëm do të jetë i pavarur nga secili Aksionar, me kusht që, për shmangien e dyshimit, asnjë auditor i emëruar në një kapacitet jo-auditues nga një Aksionar nuk do të konsiderohet i pavarur për qëllimet e këtij Neni si rezultat i këtij emërimi. Auditori i Jashtëm do të kryejë funksione të tilla që kërkohet të kryejë nga ligji në fuqi ose siç udhëzohet të kryejë nga Asambleja e Përgjithshme. Kontabilisti i parë i çertifikuar publik i emëruar nga Aksionari themelues do të jetë znj. Diana Ylli, Nr. i Regjistrimit E.K.R. Nr. 09, datë 11.01.2000, MAZARS sh.p.k., Numri i Identifikimit Tatimor (NUIS/NIPT) K32123006E.

Neni 31 – Rezidenca Tatimore Shqiptare

1. Aksionarët duhet të sigurohen që të ndërmerren të gjitha hapat e nevojshëm që Shoqëria të konsiderohet për të gjitha qëllimet si rezidente në Shqipëri. Kjo do të përfshijë vendndodhjen dhe ushtrimin e kontrollit qendror ose menaxhimit efektiv të Kompanisë nga brenda Shqipërisë.
2. Shoqëria do të jetë përgjegjëse për çdo detyrim tatimor kombëtar dhe vendor, siç kërkohet sipas të gjitha ligjeve të zbatueshme shqiptare.

Neni 32 – Politika e Dividendëve

1. Shoqëria dhe Aksionarët, në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm dhe në varësi të kërkesave të parave të gatshme të Shoqërisë, do të shpërndajnë dividentë tek Aksionarët në një mënyrë që është në përputhje me Politikën e Dividendëve.
2. Çdo shpërndarje e dividentëve do të bëhet në mënyrë proporcionale me Interesat e Pronësisë së Aksionarëve, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe këtë Statut.

Neni 33 – Financimi

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS ANGLEZE
SAMIR SHEFA
CERTIFIKATË NR.34



1. Shoqëria do të vetëfinancohet nga fluksi i parave të gatshme të Biznesit, përveç kapitalit të investuar nga Aksionarët, siç specifikohet në Planin e Biznesit dhe Buxhetin Vjetor.
2. Nëse Shoqëria kërkon ndonjë financim shtesë, Shoqëria do të financohet, për aq sa është e mundur, sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:
(a) fonde të gjeneruara nga Shoqëria;
(b) sipas rastit bazuar në nevojat e Shoqërisë dhe Aksionarëve, një nga: (i) kreditë (ose format e tjera të financimit jo-kapital) që do të ofrohen nga Aksionarët sipas kushteve dhe afateve që Aksionarët dhe Shoqëria mund të bien dakord herë pas here, në varësi të ligjit tatimor në fuqi; ose (ii) financimi i borxhit nga palët e treta sipas kushteve që do të bien dakord midis Shoqërisë, Aksionarëve dhe çdo pale të tretë përkatëse, në bazë të faktit se çdo siguri e kërkuar në lidhje me një financim të tillë të jashtëm, nëse është e mundur, do të ofrohet nga Shoqëria; ose
(c) forma të tjera të financimit që mund të jenë të përshtatshme, bazuar në konsiderata financiare, tatimore dhe ligjore.
3. Aksionerët nuk do të kenë asnjë detyrim për të siguruar ndonjë financim të mëtejshëm për Shoqërinë ose ndonjë garanci ose siguri në lidhje me një financim të tillë, por, nëse e bëjnë këtë, secilit Aksionar do t'i jepet mundësia për të siguruar një financim të tillë në përpjesëtim me Interesin e tyre të Pronësisë.

TITULLI V

SHPËRBËRJA, LIGJI QË RREGULLOHET DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 34 – Shpërbërja dhe Likuidimi

1. Shoqëria do të shpërbëhet dhe likuidohet me ndodhjen e parë të ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme (secila një "Ngjarje Shpërbërjeje"):
(a) nxjerrja nga Asambleja e Përgjithshme e një vendimi shpërbërjeje pas një Njoftimi Daljeje në rrethanat e përshkruara në Nenin 9.2(a) të këtij Statuti;
(b) siç është rënë dakord ndryshe nga Aksionarët me Shumicën e Kualifikuar të Aksionarëve;
(c) vazhdimi i një Ngjarjeje Bllokimi pa zgjidhje, në rrethanat dhe duke ndjekur procedurën e përcaktuar në Marrëveshjen e Aksionarëve; dhe
(d) me ndodhjen e ndonjë prej ngjarjeve që shkaktojnë shpërbërje sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
2. Me ndodhjen e një Ngjarjeje Shpërbërjeje, Shoqëria do të vazhdojë vetëm për qëllime të përfundimit të punëve të saj në mënyrë të rregullt, likuidimit të aseteve të saj dhe përmbushjes ose marrjes së masave të arsyeshme për përmbushjen e kërkesave të kreditorëve të saj dhe Aksionarëve. Asnjë Aksionar nuk do të ndërmarrë asnjë veprim në cilësinë e tij si Aksionar që është i papajtueshëm, i panevojshëm ose i papërshtatshëm për mbylljen e Biznesit dhe punëve të Shoqërisë. Të gjitha marrëveshjet dhe detyrimet e përfshira në këtë Statut do të vazhdojnë të jenë plotësisht të detyrueshme për Aksionarët (në varësi të ligjit në fuqi) deri në kohën kur asetet ose prona ose të ardhurat nga shitja e tyre të jenë shpërndarë në përputhje me kushtet e këtij Neni dhe ligjit në fuqi.

3. Çdo aset i mbetur i Shoqërisë do t'u shpërndahet Aksionarëve në mënyrë proporcionale me Interesat e tyre të Pronësisë, në varësi të ligjit në fuqi.

Neni 35 – Ligji Rregullues

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS ANGLEZE
SAMIR SHEFA
CERTIFIKATË NR.

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Aksionarëve, këtë Statut dhe dispozitat e ligjit shqiptar.

2. Çdo çështje që nuk parashikohet në këtë Statut do të rregullohet nga dispozitat e Marrëveshjes së Aksionarëve, Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe çdo ligji tjetër në fuqi shqiptar.

Neni 36 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Aksionarëve, ose midis Aksionarëve dhe Shoqërisë, në lidhje me interpretimin, zbatimin ose vlefshmërinë e këtij Statuti ose Marrëveshjes së Aksionarëve, do t'i nënshtrohet arbitrazhit përfundimtar dhe detyrues në përputhje me procedurat e përcaktuara në Marrëveshjen e Aksionarëve.
2. Çdo mosmarrëveshje tjetër që lind midis Shoqërisë dhe palëve të treta (jo-Aksionerë) do t'i nënshtrohet juridiksionit të gjykatave kompetente shqiptare në përputhje me ligjin shqiptar në fuqi.

Neni 37 – Konfidencialiteti

Shoqëria dhe anëtarët e organeve të saj korporative, punonjësit dhe konsulentët e saj duhet të mbajnë konfidencial të gjithë Informacionin Konfidencial dhe të gjithë Informacionin e Ndjeshëm Tregtar të Aksionerëve dhe Shoqërisë, në përputhje me Marrëveshjen e Aksionarëve dhe me politikat e brendshme të konfidencialitetit të miratuara nga Këshilli. Zbulimi mund të bëhet vetëm siç lejohet shprehimisht sipas Marrëveshjes së Aksionarëve, ligjit në fuqi ose me pëlqimin paraprak me shkrim të palës zbuluese.

Neni 38 – Konflikti midis këtij Statuti dhe Marrëveshjes së Aksionerëve

Në rast të ndonjë konflikti, mospërputhjeje ose ndryshimi midis ndonjë dispozite të këtij Statuti dhe dispozitave të Marrëveshjes së Aksionarëve, dispozitat e Marrëveshjes së Aksionaëve do të mbizotërojnë midis Aksionarëve në masën maksimale të lejuar nga ligji i zbatueshëm shqiptar, dhe Aksionerët duhet të sigurojnë menjëherë që ky Statut të ndryshohet në mënyrë që të pasqyrojë kushtet e Marrëveshjes së Aksionarëve.

Neni 39 – Statuti Dygjuhësh dhe Gjuha Mbizotëruese

1. Ky Statut ekzekutohet si në gjuhën angleze ashtu edhe në atë shqipe. Versioni në anglisht dhe versioni në shqip i këtij Statuti do të formojnë së bashku një instrument të vetëm.
2. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, paqartësie ose konflikti midis versionit në anglisht dhe versionit në shqip të këtij Statuti, versioni në anglisht do të mbizotërojë.
3. Versioni në shqip i këtij Statuti do të përdoret për qëllime të paraqitjes në QKB dhe autoritetet e tjera shqiptare, dhe për përdorim në procedurat para gjykatave dhe organeve administrative shqiptare, siç kërkohet nga ligji i zbatueshëm shqiptar. Versioni në anglisht do të jetë versioni i përdorur në marrëdhëniet midis Aksionarëve dhe si referencë për interpretimin e këtij Statuti.

Neni 40 – Dispozitat Përfundimtare

1. Çështjet që nuk rregullohen shprehimisht nga ky Statut do të rregullohen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar, dhe nga ligjet e tjera të zbatueshme shqiptare.

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS
SAIMIR SHEFA
CERTIFIKATË
ANGLEZE

2. Nëse ndonjë dispozitë ose pjesë e ndonjë dispozite të këtij Statuti është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme sipas ligjit në fuqi, kjo nuk do të ndikojë ose dëmtojë ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të këtij Statuti.
3. Ky Statut do të jetë i detyrueshëm për dhe do të vazhdojë në dobi të Aksionerëve dhe pasardhësve të tyre përkatës dhe cesionarëve të lejuar.

Gjeneve, 4 Gusht, 2026

AKSIONARËT THEMELUES

Per KAYO sh.a.

Z. Ardi VELIU
ADMINISTRATOR

Per Fincantieri S.p.A.

Z. Gianluca ZANUTTO
ZV/DREJT. SHITJE TEKNIKE DHE OFFSETEVE
DIVIZIONI I ANIJEVE DETARE

PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS ANGLEZE
SAIMIR SHEFA
CERTIFIKATË NR.34

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MARIA M. DANO

V20260531902765888B6

DATE 07/08/2026
NR REP 3532

PULLE TARIFE 200 LEKE R.SHQIPERISE

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 07/08/2026, para meje Notere MARIA M. DANO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Mihal Duri, Nr. 4, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES: **Z. Saimir Shefa,** atësia Kujtim, amësia Behije, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje, Lushnjë dhe banues në LUSHNJE, me adresë Lute Bano 01710137; Nd. 59; H. 1; Ap. 3; Lushnjë; Lushnjë; 9001; Lushnje, lindur më 10/09/1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u binda sipas Leternjoftimit ID nr. 036804484 dhe nr. personal I40910100D.

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyesit.

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER/ MARIA M. DANO